

RREGULLORJA MBI PËRDORIMIN E AUTOMJETEVE TË KOMPANISË – “ E N L.L.C”.

Kjo rregullore rregullon përdorimin e të gjitha automjeteve në kuadër të kompanisë.

Rregullorja është e ndarë në seksione ku përshkruhet përdorimi i automjeteve, përvoja në vozitje, mirëmbajtja, raportimi i aksidenteve, këshilla për vozitje dhe të sigurisë.

Në rast se ndonjë anëtar i stafit nuk u bindet dispozitave të kësaj rregulloreje, do të ndëshkohet sipas përgjegjësisë materiale, disiplinore e penale, varësisht prej rastit.

PËRDORIMI I AUTORIZUAR I AUTOMJETEVE

1. Pjesa e përgjithshme

- 1.1. Automjetet e kompanisë do të shfrytëzohen për kryerjen e detyrave zyrtare.
- 1.2. Anëtari i stafit do ta shfrytëzojë automjetin në mënyrë të përgjegjshme dhe të sigurt, në përshtatje me Rregulloren e tanishme të kompanisë.
- 1.3. Anëtari i stafit që ka nevojë të shfrytëzojë automjetin për nevoja zyrtare do të plotësojë formularin dhe ta dërgon përmes emailit në zyrën e transportit. Pas përdorimit të automjetit çelësat do të kthehen në zyrën e transportit. Gjithashtu edhe anëtarët e stafit të cilët janë të ngarkuar me një automjet të caktuar dhe të cilët edhe kanë nënshkruar Procesverbalin mbi Pranim Dorëzimin e Automjetit, pas përfundimit të orarit të punës automjetin së bashku me çelësat do ti dorëzojnë në vendin e caktuar. Në rast se automjeti kthehet pas mbarimit të orarit të punës dhe kur zyra është e mbyllet, çelësat do të dorëzohen në Portën e Sigurimit.
- 1.4. Për shfrytëzimin e automjetit jashtë Kosovës gjithmonë duhet të bëhet kërkesë e cila duhet të aprovohet dhe nënshkruhet nga Drejtori.
- 1.5. Vozitja e automjetit jashtë detyrës nuk është e lejuar. Automjeti do të përdoret vetëm për punë dhe detyrat e punës në asnjë rast nuk do të përdoret për nevoja tjera.

2. Personi përgjegjës për mirëmbajtjen dhe administrimin e Flotës

Zyrtari i autorizuar, e në këtë rast udhëheqësi i zyrës së transportit së kompanisë është përgjegjës për administrimin, mirëmbajtjen, servisimin, ndërrimin e pjesëve të automjetit, regjistrimin dhe sigurimin e automjeteve, ndërmarrjen e veprimeve juridike në lidhje me kompensimin e dëmeve në kompanitë e sigurimeve dhe evidentimin e dëmtimeve të automjeteve.

Zyrtari i zyrës së transportit të kompanisë duhet të merr masa adekuate në mënyrë që të ndalon drejtimin e automjeteve anëtarëve të stafit të cilët nuk posedojnë patent shofer.

Servisimi, riparimi dhe brendimi i automjeteve bëhet vetëm në servisën e operatorit ekonomik të kontraktuar nga kompania, në përjashtim në rast se vetura prishet jashtë vendit dhe riparimi mund të bëhet edhe në servis tjetër, me kusht që të posedojë faturë dhe raport me shkrim nga ngasësi i veturës.

Gjatë marrjes së automjetit zyrtar nga servisi, zyrtari i transportit, duhet të verifikojë nëse janë riparuar defektet për të cilat automjeti është dërguar në servisë .

Zyra e transportit është përgjegjëse edhe për përgatitjen e automjeteve për sezonin verorë dhe dimërorë, duke i pajisur ato me goma adekuate sezonale si dhe aksesore tjerë të nevojshëm.

Zyra e transportit duhet të evidentojë dhe të raportoj për çdo gjë që ka të bëjë me automjetin, si për shembull gërvishnje, dëmtimin, si dhe humbjen e çdo aksesori tjetër të automjetit.

3. Monitorimi i automjeteve me sistemin GPS

3.1. Të gjitha automjetet e kompanisë janë pajisura me aparatet e përcjelljes GPS dhe Kamera , me anë të së cilave bëhet monitorimi i lëvizjes së automjeteve 24 orë në ditë, si brenda ashtu edhe jashtë territorit të Kosovës.

3.2. Monitorimi i automjeteve bëhet nga zyra e cila gjendet në kuadër të kompanisë, zyre kjo e cila përkujdeset që të respektohen të gjitha pikat e kësaj rregulloreje.

3.3. Zyra e monitorimit harton Raporte Ditore të ndryshme me anë të së cilës tregohet efikasiteti gjatë orarit të punës, siç janë:

- (a) Raporti për fillimin dhe përfundimin e orarit të punës,
- (b) Raporti për respektimin e vizitave ditore të përcaktuara sipas planifikimit,
- (c) Raporti për dorëzimin e pakove ,
- (d) Raporti për shpenzimet e derivateve,
- (e) Raporti për tejkalimin e shpejtësisë,
- (f) Raporte të veçanta, sipas kërkesës nga Drejtori.

4. Kualifikimi për vozitje

Asnjë personi nuk do t'i lejohet përdorimi i automjeteve të kompanisë nëse nuk janë të pajisur me patent-shofer valide dhe nëse nuk është anëtar i stafit të kompanisë.

5. Vozitja nën ndikimin e alkoholit

Vozitja nën ndikimin e alkoolit është rreptësisht e ndaluar, dhe njëra prej kushteve të cilat nuk do të ketë tolerim, shkelje që do të ndikojnë në mënyrë direkte për shkëputjen e kontratës, gjithashtu do të njoftohen edhe organet e rendit dhe te drejtësisë për një shkelje të këtillë.

6. Kufizimet e shpejtësisë

6.1. Kufizimet e shpejtësisë, të përcaktuara nga autoritetet lokale dhe qendrore, duhet zbatuar gjithnjë dhe në çdo kohë.

6.2. Me qëllim të evitimit të aksidenteve eventuale dhe mirëmbajtjes së automjeteve, për çdo evidentim të tejkalimit të shpejtësisë të përcaktuara nga autoritetet përkatëse shtetërore dhe ligjeve të zbatueshme për komunikacionin rrugorë do të pasojnë ndëshkimet si në vijim, (pavarësisht ndëshkimit nëse mirët nga Organet e Rendit) në çdo rastë që vërtetohet se drejtuesi i automjetit ka shkelur rregullat e trafikut, do të ndëshkohet me dënime si në vazhdim e të cilat dënime do të ndalen nga të ardhurat personale:

- Tejkalimi i Shpejtësisë deri në 10 km/h (Ndalese 10€)
- Tejkalimi i Shpejtësisë deri në 20 km/h (Ndalese 20€)
- Tejkalimi i Shpejtësisë deri në 30 km/h (Ndalese 30€)
- Tejkalimi i Shpejtësisë deri në 40 km/h (Ndalese 40€ + Vërejtje me Shkrim)
- Tejkalimi i Shpejtësisë deri në 50 km/h (Ndalese 50€ + Vërejtje me Para përjashtim)

7. Vënia e rripit të sigurisë

Çdo bartës i automjetit duhet të vendosë rripin e sigurisë gjatë gjithë kohës sa ai udhëton me automjetin e kompanisë. Është përgjegjësi e vozitësit që të sigurojë që edhe udhëtari/ët e tij të vendosin rripin e sigurisë.

8. Pirja e Duhanit brenda automjeteve

Pirja e duhanit brenda automjetit është rreptësisht e ndaluar, dhe paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës.

9. Transportimi i personave që nuk janë anëtarë të stafit apo mallrave të cilat nuk janë pjesë e kompanisë

9.1. Është rreptësisht e ndaluar që automjetet e kompanisë të përdoren për transportimin e personave dhe mallërave që nuk janë pjesë e kompanisë apo autorizuar nga kompania.

9.2. Vozitësi, i cili, përkundër udhëzimeve, transporton personin e pa-autorizuar (personin i cili nuk gjendet në listën e personave të punësuar në kompani apo i autorizuar për të udhëtuar

X2

me automjetet e kompanisë), përgjegjësia në rast aksidenti, lëndimi apo vdekjeje bie mbi udhëtarët e tij/saj.

10. Kontrollimi ditor gjatë përdorimit

10.1. Mirëmbajtja nga ana e vozitësit është aspekti më i rëndësishëm i sistemit të mirëmbajtjes së mirë, në mënyrë që të parandalohen shkatërrimet dhe defektet e vogla mekanike duhet të raportohen para se ato të bëhen të mëdha. Nëse automjeti ka nevojë për servisim, personi që e përdor atë duhet të kontaktojë me zyrën e transportit.

10.2. Vozitësit janë përgjegjës për sigurinë e automjetit dhe përmbytjes së tij. Automjeti i tyre duhet lënë pa mbikëqyrje vetëm nëse është i parkuar në vend të sigurt dhe kjo bëhet kur është vërtetuar se automjeti është siguruar (mbyllja e dyerve, dritareve, mekanizmi për mbylljen e timonit ose ndërruesit të shpejtësive). Nuk duhet lënë në makinë gjëra që bien në sy dhe që kanë vlerë për shkak të provokimit të thyerjes së dritareve etj. Është përgjegjësi e vozitësit që të sigurohet se automjeti i tij është parkuar drejt dhe i siguruar gjithë kohën nga roja e parkingut kundër vjedhësve, aksidenteve, vandalizmit apo humbjeve tjera.

10.3. Pos simbolit të aprovuar, automjetet e kompanisë nuk do të mbajnë asnjë shenjë tjetër dalluese apo simbol.

10.4. Asnjë automjet nuk do të drejtohet nëse ai nuk është në gjendje të sigurt mekanike për vozitje.

10.5. Vozitësit janë të obliguar që të gjitha kopjet e faturave të furnizimit me karburante, riparimet eventuale të automjeteve (gjatë udhëtimit zyrtarë) larjes dhe shpenzimeve tjera të automjeteve ti dorëzojnë në zyrën e transportit, të cilat ju duhen për hartimin e raportit mujorë për shpenzimet e të gjitha automjeteve të kompanisë.

10.6. Kontrolli ditor para nisjes:

Pastërtia e automjetit

Niveli i ujit ftohës;

Niveli i fluidit të frenave;

Treguesit në tabelën e instrumenteve, posaçërisht treguesi i karburantit;

Dritat e përparme dhe të pasme si dhe treguesit;

Veglat e makinës dhe pajisjet ndihmëse;

Boria;

Kilometrazhi për mirëmbajtjen e ardhshme; dhe

Kontrolli i jashtëm të makinës (gomat, dëmtimet në karroseri, rrjedhjet eventuale, etj.)

11. Raportimi, shqyrtimi dhe veprimi në rast aksidenti

7.1. Kurdo që një automjet i kompanisë është i përfshirë në ndonjë aksident, vozitësi duhet të ndërmarrë këto veprime:

(a) Të ndalë automjetin dhe të qëndrojnë në vendin e ngjarjes përderisa veprimet që cekën më poshtë të mos kryhen dhe siguria e tij/saj të mos jetë e rrezikuar. Vozitësi duhet të kontaktojë policinë dhe të marrë raportin nga policia.

(b) Të jap ndihmën e parë ndonjërit nga të lënduarit nëse ai/ajo ka mundësi ta japë.

(c) "Raporti mbi shkatërrimin/dëmtimin e automjetit" që mbahet në dosjen e fletë udhëtimit duhet të plotësohet në vendin e ngjarjes së fatkeqësisë dhe të dërgohet në zyrën e transportit brenda 24 orëve, ndërsa kopja e tij t'i dërgohet kompanisë së sigurimit të automjetit brenda 48 orëve.

(d) Në rast të lëndimit apo shkaktimit të dëmit në pasuri palës së tretë, pos procedurës së përcaktuar më lart, vozitësi duhet të njoftojë policinë lokale ose drejtpërdrejt ose përmes Zyres se Transportit.

(e) Kur policia nuk është prezent, vozitësi i automjetit të kompanisë duhet të marrë shënimet e vozitësit të automjetit tjetër ose pronarit të pasurisë tjetër ose personit/ve që janë përfshirë në fatkeqësi, dhe personit/ve të përfshirë në fatkeqësi si emrin, numrin e letërnjoftimit dhe numrin e regjistrimit të automjetit.

(f) Siguron automjetin dhe përmbajtjen e tij kundër vjedhjeve dhe siguron që automjetet e përfshira në fatkeqësi nuk kanë lëvizur nga vendi i ngjarjes derisa të vijë policia/personi i autorizuar për hulumtim, përveç nëse automjeti paraqet rrezik për jetën e njerëzve/ose fatkeqësi të rëndë trafiku.

(g) Pavarësisht nga serioziteti i fatkeqësisë, të gjitha aksidentet duhet raportuar zyrës së transportit sa më parë që të jetë e mundur.

(h) Nëse automjeti është plotësisht i bllokuar, duhet kërkuar ndihmë nga zyra e transportit. Automjetet e përfshira në aksidente nuk duhet lënë pa mbikëqyrje në vendin e ngjarjes.

7.2. Varësisht nga faktorët e ndryshëm, Menaxhmenti i kompanisë do të rishikojë aksidentin e automjeteve për të përcaktuar, pos tjerash, a duhet, dhe gjerë në cilën masë, vozitësi i përfshirë në aksident duhet të mbahet përgjegjës personalisht dhe financiarisht për ndonjë shpenzim apo humbje shkaktuar si pasojë e fatkeqësisë. Bazuar në këtë përcaktim, një shumë e duhur pagese mund të ndalet nga paga për të mundësuar veprimin kthyes pasues.

7.3. Në rast të vetaksidentit, aksidentit ndaj palëve të treta me çrast kompanisë i është shkaktuar dëm material në veturë, punonjësi që ka shkaktuar dëmin do të ndalen nga të ardhurat personale nga kompania si në vijim:

- Shkaktimi i dëmit hera e parë (Ndalësia 50€ dhe vërejtje me shkrim)
- Shkaktimi i dëmit hera e dytë (Ndalësia 80€ dhe vërejtje me para përjashtim)

7.4. Për dëmet e shkaktuara nga shfrytëzuesi i veturës të cilat nuk i mbulon kompania e sigurimit sipas policës së sigurimit dhe kontratës duke marrë parasysh përqindjen e mbulimit të dëmit nga kompania siguroese, përgjegjës për mbulimin e dëmit komplet apo i pjesës së pambuluar nga kompania siguroese është shfrytëzuesi i automjetit.

Vlerësimi i dëmit dhe mbulimi i riparimit të dëmit bëhet nga servisi i autorizuar.

12. Humbja apo vjedhja e automjetit zyrtarë

Në rast të humbjes apo vjedhjes së automjetit zyrtar, drejtuesi i automjetit është i obliguar që së pari të raportoj rastin në stacionin më të afërm policor dhe pastaj edhe zyrën e transportit.

13. Ndryshimi i Rregullores

Kjo rregullore mund të ndryshohet me procedurë të njëjtë me atë të miratimit.

14. Aplikueshmëria

Kjo rregullore është e aplikueshme nga data e aprovimit të saj.

Datë: 01.11.2020

Drejtori

Fatlinda Zylfiu Hajredini
